VENDIM
Nr. 17, datë 18.2.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "AYEN ENERGY TRADING" SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d"; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë "Ayen Energy Trading" sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Ayen Energy Trading" sh.a., zotëron licencën me nr. 230, seria FK14, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 30, datë 31.3.2014. Afati i kësaj licence përfundon në datën 31.3.2019.

- Shoqëria "Ayen Energy Trading" sh.a., ka aplikuar në ERE për rinovimin licencës në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93 prot., datë 28.1.2019.

- Aplikanti ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës, në zbatim të afateve të parashikuara në nenin 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë "Ayen Energy Trading" sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike(neni 9, pika 4.7, germat "a", "b", "e" dhe "f", pika 4.7.1, germat "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me "Formati dhe dokumentacioni për aplikim", neni 9, pika 1, germa "b" (mungon prokura e përfaqësuesit); "Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike", neni 9, pika 1, germa "d" (Informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave), neni 9, pika 4.7.1, germa "a" (Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 230, seria FK14, të shoqërisë "Ayen Energy Trading" sh.a., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego